

ALBAVIA sh.p.k
Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit të pavarur
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1-2
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCES	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 23

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe ortakëve të Shoqërisë Albavia sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Albavia sh.p.k** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financier më datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financier të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2017, performancën e saj financiare dhe flukset e parashës për vitin që mbylli në këtë datë, në përputhje Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësë, përvèç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale perveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e proçesit të raportimit financier të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mosbulimit të një anomalie si pasojë e mashtimit është më i lartë se rreziku i mosbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësimë të qëllimshme, keqinterpretimë, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehem i lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësës, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasiguri materiale mbi aftesinë e Shoqërisë për të vazduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, perveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjëjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

26 mars 2018

Luan Kamberi
Auditores Ligjor



**Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2017**

	Shënimi	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	89,896,368	73,668,812
Llogari të arkëtueshme tregëtare	5	414,643,381	386,255,817
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	502,840,302	442,709,407
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	24,208,579	15,699,189
Inventarë	8	45,008,867	21,350,358
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	351,802,827	448,677,757
Total Aktive Afatshkurtra		1,428,400,324	1,388,361,340
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	519,813,747	532,674,680
Llogari të arkëtueshme afatgjata	11	23,224,485	136,970,781
Total aktive afatgjata		543,038,232	669,645,461
Total aktive		1,971,438,556	2,058,006,801
DETÝRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	16	1,982,174	-
Llogari të pagueshme tregtare	12	554,280,541	528,415,307
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	13	126,454,853	130,727,621
Detyrime tatumore	14	3,691,430	3,805,185
Të tjera detyrime	15	8,948,209	8,626,815
Total Detyrime afatshkurtra		695,357,207	671,574,928
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	16	195,525,717	164,537,090
Paradhënie e të ardhurat e shtyra	17	569,555,870	752,636,872
Llogari të pagueshme afatgjata	18	125,688,149	104,817,276
Total detyrime afatgjata		890,769,736	1,021,991,238
Totali i detyrimeve		1,586,126,943	1,693,566,166
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		135,300,000	135,300,000
Rezerva ligjore		12,652,894	11,946,854
Rezerva të tjera		216,386,070	203,048,005
Rezerva statutore		25,006	25,006
Fitimi i ushtrimit		20,947,643	14,120,770
Total kapitali	19	385,311,613	364,440,635
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,971,438,556	2,058,006,801

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Konsoliduar e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Shënimë	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	20	1,202,263,892	812,000,626
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	21	(7,013,020)	3,673,823
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera		(1,038,969,026)	(670,696,768)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	22	(1,021,645,287)	(650,516,459)
2) Të tjera shpenzime	23	(17,323,739)	(20,180,309)
Shpenzime te personelit	24	(73,031,766)	(70,861,666)
1) Paga dhe shperblime Shpenzime te sigurimeve		(62,881,600)	(61,323,967)
2) shoqerore/shendetsole (paraqitur vecmas nga shpenzimet per pension)		(10,150,166)	(9,537,699)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(45,508,860)	(46,273,225)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	25	(676,476)	(154,062)
Shpenzime financiare	26	(12,239,887)	(10,146,423)
1) Shpenzime interesë dhe shpenzime te ngjashme (paraqitur vecmës shpenzimet per t'u paguar tek njesite ekonomike brenda grupit)		(12,483,381)	(10,358,550)
2) Shpenzime te tjera financiare		243,494	212,127
Fitimi/humbja para tatimit		24,824,857	17,542,305
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(3,877,214)	(3,421,535)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	27	(3,877,214)	(3,421,535)
2) Shpenzimi aktual i tatimit te shtyre		-	-
Fitimi/humbja e vtit		20,947,643	14,120,770
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		20,947,643	14,120,770

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e Konsoliduar e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Pozicioni më 1 janar 2016	Kapitali i nënshtkuar	Rezerva Statutore dhe ligjore	Rezerva të tjera	Rezerva të rivlerësimt	Fitimet e Pashpëndara	Fitim / Humbja e vitt	Totali
	135,300,000		11,326,690	190,860,724	(2,029)	-	12,903,393
							350,388,778

Totali i të ardhurave

Gjithëpërfshirëse për vitin:

Efektet e ndryshimit të kursit të këmbimit në konsolidim

Fitimi / Humbja e vitt

Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse:

Transferim në rezerva

Pozicioni më 31 dhjetor 2016	135,300,000	11,971,860	203,118,947	(70,942)	-	14,120,770	(12,903,393)	364,440,635

Totali i të ardhurave

Gjithëpërfshirëse për vitin:

Efektet e ndryshimit të kursit të këmbimit në konsolidim

Fitimi / Humbja e vitt

Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse:

Transferim në rezerva

Pozicioni më 31 dhjetor 2017	135,300,000	12,677,900	216,533,677	(147,607)	-	20,947,643	(14,120,770)	20,947,643

Totali i të ardhurave	Gjithëpërfshirëse për vitin:
	Efektet e ndryshimit të kursit të këmbimit në konsolidim
	Fitimi / Humbja e vitt
	Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse:
	Transferim në rezerva

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë aprovuar nga administratori i Albavia sh.p.k më _____ dhe janë firmosur si më poshtë.

Shkaktim Rakipaj
Hasan Hafizi
Administratorë



Pasqyra e Konsoliduar e Fluksit të Mjeteve Monetare
 Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	20,947,643	14,120,770
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	389,380	952,554
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	45,508,860	46,273,225
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	140,263	449,089
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënje/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	113,593,377	249,934,663
Rënje/(rritje) në inventarë	(23,658,509)	10,209,402
Rritje/(rënje) në detyrimet e pagueshme	<u>(140,799,404)</u>	<u>(320,498,268)</u>
Mjete monetare neto nga/(përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit	16,121,610	1,441,435
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(32,888,190)	(44,326,941)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	100,000	125,000
Mjete monetare neto nga/(përdorur në aktivitetin e investimit	(32,788,190)	(44,201,941)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në aktivitetin e financimit		
Levizjet e huave	30,988,627	26,371,090
Mjete monetare neto nga/(përdorur në aktivitetin e financimit	30,988,627	26,371,090
Rritje/(rënje) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	14,322,047	(16,389,416)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	73,668,812	90,127,141
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit nga përkthimi	(76,666)	(68,913)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4	87,914,193
		73,668,812

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 23, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Albavia Shpk është një shoqëri e regjistruar më 26 Mars 1998, me vendim gjykate Nr. 19077 datë 20 Mars 1998. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 7638 datë 19 Nëntor 1992 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj. Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 135,300,000 lekë.

Shoqëria ka NIPT J81527001Q. Selia e Shoqërisë është Rr. Sulejman Delvina, pranë Zayed Center, Ap.19, Tiranë.

Ortakët e Shoqërisë më 25.10.2017 janë:

- Z. Genc Hafizi, qytetar shqiptar që zotëron 52 %
- Z. Shkëlqim Rakipaj, qytetar shqiptar që zotëron 48%

Me pas e ne vazhdim :

- Z. Hasan Hafizi, qytetar shqiptar që zotëron 52 %
- Z. Shkëlqim Rakipaj, qytetar shqiptar që zotëron 48%

Aktiviteti kryesor i kësaj Shoqërie është ndërtimi i rrugëve, ujësjellësa e kanalizime, ndërtime civile e industriale, prodhimi i materialeve asfaltike etj.

Në 31 dhjetor 2017 shoqëria ka 138 punonjës. (2016: 119)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe moneda funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësimë dhe gjykime

Paraqitura e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të kryejë vlerësimë dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financier, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimesht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjera duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësimë dhe gjykime në lidhje me të ardhmen.

Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësimë bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizonet

Provizonet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste Shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Sic paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvèc rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financaire sic kërcohët nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
EUR/LEK	132.95	135.23
USD/ LEK	111.10	128.17

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi i që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument finansiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet finansiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finansiar ose kur shoqëria transferon aktivin finansiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve finansiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet finansiarë çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitet financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij finansiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizonit llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferençë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë përiudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimet e përfshirë për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjera jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv finansiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivit.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin finansiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njoftes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve fë përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Aktivet afatgjata materiale (AAM) paraqiten në bilanc me vlerën e tyre bruto minus amortizimin e akumuluar. Shtesat e Aktiveve Afatgjata regjistrohen në kontabilitet me koston e marrjes ose të prodhimit të tyre.

Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë atë aktiv në vendin dhe kushtet ekzistuese. Normat e amortizimit të aplikuara janë sipas kërkësave fiskale dhe nuk marrin në konsideratë vlerësimin e amortizimit sipas jetës së dobishme të aktivit.

Për llogaritjen e amortizimit janë aplikuar këto norma amortizimi:

Kategoria e AQT-ve	Norma e Amortizimit në %		Metoda e llogaritjes
	2017	2016	
Toka	0%	0%	
Ndërtime e instalime	5/10%	5%	
Makineri e Paisje	10 %	5/10 %	
Mjete transporti	10 %	5/10 %	Mbi vlerën e mbetur të AQT-ve
Paisje zyre	20%	5%	
Paisje kompjuterike	25%	25%	
Instrumenta dhe vegla pune	20%	5%	

Për amortizimin e fabrikës së asfaltit janë përdorur norma amortizimi tëdiferencuara dhe konkretisht:

Kategoria e AQT-ve	Norma e Amortizimit në %		Metoda e llogaritjes
	2017	2016	
Implanti Teknologjik	5 %	5 %	Mbi vlerën e mbetur të AQT-ve
Paisje energjytike e elektrike	5 %	5 %	
Paisje të tjera teknike	5 %	5 %	

Llogaritia e amortizimit për AQT e hyra gjatë vitit bëhet duke filluar nga data një e muajit pasardhës.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëherëshme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përvèç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesni nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesni njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesni mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatimi fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatimi fitimi i shtyrë. Tatimi fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përvèç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 eshte 15% (2016: 15%).

Tatimi fitimi i shtyrë përfaqëson diferençën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferençat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferençën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit finansiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferençat e përkohshme do të anullohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferençat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3. Politikat Kontabёl (vazhdim)

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridikcionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizonet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kérkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizonet rimerren.

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njilën në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënimë të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënimë për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nësë është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Mjete monetare në bankë	89,131,709	58,732,765
Vlera në arkë	491,314	14,658,014
Total mjete monetare Albavia Shqipëri	89,623,023	73,390,779
Total mjete monetare Kosova	273,345	278,033
	89,896,368	73,668,812

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Klientë për punime në infrastrukturë rrugore	163,733,366	208,455,374
Klientë për shitje apartamentesh	47,186,995	59,363,420
Klientë për shitje produktesh	4,511,936	2,621,778
Klientë për të tjera	137,811,354	68,779,945
Klientë për garanci punimesh	61,399,730	47,035,300
	414,643,381	386,255,817

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Albavia & Sintram (Kërkesa për arkëtim)	380,639,220	236,845,111
Albavia & Sintram (Të tjera kërkesa)	9,056,354	16,456,948
Emuliv	7,245,507	8,006,792
Karl Gega	105,899,221	172,046,756
Genc Hafizi	-	9,353,800
	502,840,302	442,709,407

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Pjesa e detyrimeve dhe gjobave kompesuar por që janë në proces gjyqësor (Albavia Shqipëri)	2,908,307	2,908,307
TVSH për t'u rregulluar	1,285	111,155
Tatim në burim për t'u rregulluar (paguar në Kosovë)	217,499	217,499
Të tjera	345	35,698
Të tjera llogari të arkëtueshme	21,081,143	12,426,530
	24,208,579	15,699,189

8. Inventari

Inventari paraqitet si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Stoku i materialeve të para	32,414,959	10,704,298
Stoku i materialeve ndihmëse	7,762,907	6,997,323
Inventari i imët	4,831,001	3,648,737
	<u>45,008,867</u>	<u>21,350,358</u>

9. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Leja e ndërtimit për ndërtimin e banesës	6,100,431	6,159,331
Parapagime Gener 2 për Qukësin	286,037,265	397,107,182
Parapagime per furnizim vendosje Albit	4,166,668	4,166,668
Sigurime objekti Interalbania	1,400,000	466,666
Te tjera shpenzime ne avance	<u>54,098,463</u>	<u>40,777,910</u>
	<u>351,802,827</u>	<u>448,677,757</u>

10. Aktive Afatgjata Materiale

	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Mjetë transporti	Të tjera	Totali
Kosto						
Gjendja më 1 janar 2016	18,119,542	236,301,473	473,254,660	158,381,641	31,299,520	917,356,836
Shtesa	-	-	42,672,144 (37,830)	560,930 (1,001,087)	1,093,867 (9,000)	44,326,941 (1,047,917)
Nxjerrie jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 dhjetor 2016	18,119,542	236,301,473	515,888,974	157,941,484	32,384,387	960,635,860
Shtesa	-	-	25,245,097	4,615,344 (2,374,600)	3,027,749	32,888,190 (2,374,600)
Nxjerrie jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 dhjetor 2017	18,119,542	236,301,473	541,134,071	160,182,228	35,412,136	991,149,450
<i>Amortizimi i akumuluar</i>						
Gjendja më 1 janar 2016	-	60,957,804	240,992,758	63,513,038	17,300,183	382,763,783
Amortizimi i viti	-	11,815,073	21,620,446 (21,219)	9,525,531 (443,609)	2,710,175 (9,000)	45,671,225 (473,828)
Nxjerrie jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	72,772,877	262,591,985	72,594,960	20,001,358	427,961,180
Amortizimi i viti	-	11,815,073	22,276,673	8,867,618 (2,134,337)	2,549,496	45,508,860 (2,134,337)
Nxjerrie jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 dhjetor 2017	-	84,587,950	284,868,658	79,328,241	22,550,854	471,335,703
<i>Vlera neto kontabëli</i>						
Gjendja më 31 dhjetor 2016	18,119,542	163,528,596	253,296,989	85,346,524	12,383,029	532,674,680
Gjendja më 31 dhjetor 2017	18,119,542	151,713,523	256,265,413	80,853,987	12,861,282	519,813,747

11. Llogari të arkëtueshme afatgjata

Llogari të arkëtueshme afatgjata më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve (Garanci)	9,882,675	45,804,257
Gener 2 (Garanci)	13,341,810	6,149,891
Karl Gega (Garanci)	-	17,279,968
Albavia & Sintram shoqëri e thjeshtë (Garanci)	-	67,736,665
	<u>23,224,485</u>	<u>136,970,781</u>

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Furnitorë për punime të kryera	285,180,582	284,129,698
Furnitorë për materiale	212,343,486	207,490,896
Furnitorë për shërbime	14,969,960	17,336,399
Furnitorë për garanci të ndalura	41,322,783	18,986,632
	<u>553,816,811</u>	<u>527,943,625</u>
Furnitorë shërbime Kosovë	463,730	471,682
	<u>554,280,541</u>	<u>528,415,307</u>

13. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Emuliv shpk	40,246,742	40,645,440
Karl Gega konstruksion	86,208,111	90,082,181
	<u>126,454,853</u>	<u>130,727,621</u>

14. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
TVSH për t'u paguar	1,478,135	1,211,175
Tatim mbi fitimin	389,380	952,554
Tatim në burim	28,818	28,814
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,550,941	1,384,172
Tatim mbi të ardhurat e personale	243,461	228,470
Te tjera	695	-
	<u>3,691,430</u>	<u>3,805,185</u>

15. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Detyrime ndaj punonjësve	4,757,756	4,411,497
Të tjera	<u>4,190,453</u>	<u>4,215,318</u>
	<u>8,948,209</u>	<u>8,626,815</u>

16. Hua

Huatë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Leasing nga Bankat	7,962,883	5,385,995
Overdraft nga Tirana Bank	<u>189,545,008</u>	<u>159,151,095</u>
	<u>197,507,891</u>	<u>164,537,090</u>

17. Të ardhurat e shtyra

Të ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Albavia & Sintram shoq. e thjeshtë	569,555,870	752,636,872
	<u>569,555,870</u>	<u>752,636,872</u>

18. Llogari të pagueshme afatgjata

Llogaritë e pagueshme afatgjata më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Furnitorë për garanci të ndalura	75,370,240	48,926,367
Detyrime të tjera afatgjata	<u>50,317,909</u>	<u>55,890,909</u>
	<u>125,688,149</u>	<u>104,817,276</u>

Furnitorët për garanci të ndaluara lidhen me ndalesat e bëra nënkontraktorëve që janë në kontrata joint venture me Shoqërinë në objektin, "Ndertim rruga Qukes-Qafe Pilloce".

Shoqëria ka marrë hua ndaj palëve të treta individë dhe ortakëve me qëllim të financimit të investimeve si edhe përmbulimin e nevojave për kapital punues. Për këto hua nuk janë llogaritur apo paguar interesa.

19. Kapitali

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 është si mëposhtë:

	31 dhjetor 2017			31 dhjetor 2016		
	Kuotat	Vlera nominale	%	Kuotat	Vlera nominale	%
Shkëlqim Rakipaj	792	64,944,000	48%	792	64,944,000	48%
Hasan Hafizi	858	70,356,000	52%	858	70,356,000	52%
	1,650	135,300,000	100%	1,650	135,300,000	100%

20. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Kryerja e shërbimeve (Ndërtimi)	1,200,198,760	811,855,932
Nga shitja e mallrave	-	101,494
Të tjera shitje e shërbime (Makineritë)	2,065,132	43,200
	1,202,263,892	812,000,626

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	1,019,282,891
Shtohen të ardhurat e rimarra nga 2016	183,081,001
Zbriten të ardhurat e shtyra për 2017	-
Zbritet vlera kontabël neto e AMM-ve të shitura përfshirë në zërin "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit"	(240,263)
Zbriten rivlerësimet e mallrave	-
Shtohet efekti i kurseve të këmbimit të përfshira në zërin "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit"	(6,872,757)
Shtohen të ardhurat nga dogana në Janar 2015	-
Shuma e qarkullimit e korrektuar	1,195,250,872
Sipas Kontabilitetit	1,195,250,872
Diferenca	-

21. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fitim /(humbje) nga shitja e AAM-ve	(140,263)	(449,089)
Fitim /(humbje) nga kursi i këmbimit	<u>(6,872,757)</u>	<u>4,122,912</u>
	<u>(7,013,020)</u>	<u>3,673,823</u>
Fitim humbje nga shitja e aseteve	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga shitja e AMM-ve	100,000	125,000
Vlera kontrabël e AMM-ve të shitura	<u>(240,263)</u>	<u>(574,089)</u>
	<u>(140,263)</u>	<u>(449,089)</u>
Diferenca këmbimi	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Humbje nga këmbimet valutore	(28,196,293)	(12,940,238)
Fitime nga këmbimet valutore	<u>21,323,536</u>	<u>17,063,150</u>
	<u>(6,872,757)</u>	<u>4,122,912</u>

22. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostojë e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Kosto e materialeve të para	323,353,925	293,583,400
Kosto e shërbimeve të kryera	698,291,362	356,933,059
Nënkontraktorët	667,756,807	325,831,203
Transport	195,010	-
Riparime e mirëmbajtje	5,359,679	6,786,025
Shpenzime udhëtime dieta	4,964,551	2,741,600
Qira për prodhimin, magazinimin	600,000	600,000
Analiza laboratori	8,500,707	18,694,231
Konsulencë inxhinierike	<u>10,914,608</u>	<u>2,280,000</u>
	<u>1,021,645,287</u>	<u>650,516,459</u>

23. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Taksa vendore	1,203,163	743,576
Taksë regjistrimi për mjetet	1,709,574	1,112,664
Shpenzime telefoni, poste dhe internet	1,534,311	1,297,602
Shërbime bankare	1,642,691	1,783,566
Sigurime e Prime	2,715,581	2,173,312
Analiza, konsulencë dhe studime projektive	2,209,226	1,423,707
Shërbime të ndryshme nga të tretë	1,774,402	1,749,067
Pagesa administrative	72,320	545,045
Blerje energji, avull, ujë	1,676,504	805,494
Blerje kancelari	538,767	634,011
Shpenzime qeraje	1,221,580	1,244,770
Shpenzime për pritje e përfaqësime	206,500	333,442
Shpenzime të tjera	711,120	4,890,617
Transferime, udhëtime, dieta për administratën	108,000	1,443,436
	17,323,739	20,180,309
Shpenzime të tjera Kosova	-	-
	17,323,739	20,180,309

24. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Pagat e personelit	62,881,600	61,323,967
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	10,150,166	9,537,699
	73,031,766	70,861,666

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2017 është 138 (2016: 119).

25. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Gjoba dhe dëmshpërblime	676,476	154,062
	676,476	154,062

26. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin finansiar të Shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime për interesa	12,492,532	10,358,550
Të ardhura nga interesat	(9,151)	-
Shpenzime financiare	11	27
Të ardhura financiare	(243,505)	(212,154)
	12,239,887	10,146,423

27. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përllogarita e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Fitimi para tatimit		
Total shpenzime të panjohura	24,824,857	17,542,305
Shpenzime Pritje e Përcjellje	206,500	333,442
Penalitete, gjoba e dëmshpérblime	676,476	154,062
Shpenzime të tjera	140,263	4,780,427
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	25,848,096	22,810,236
 Tatim fitimi @15%	 3,877,214	 3,421,535

28. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Albavia & Sintram	389,695,574	-	321,038,724	-
Emuliv	7,245,507	40,246,742	8,006,792	40,645,440
Karl Gega	105,899,221	86,208,111	189,326,724	90,082,181
Ortaket	-	-	-	-
Genci Hafizi	-	-	9,353,800	-
	502,840,302	126,454,853	527,726,040	130,727,621

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Karl Gega	-	3,238,800	-	27,953,110
Emuliv	-	-	-	1,000,000
Albavia & Sintram	781,455,587	3,238,800	349,000,917	-
	781,455,587	3,238,800	331,109,982	28,953,110

Shpërblimin total të dhënë stafit drejtues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 është 3,137,274 Lek.

	31 dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Administratori Shkelqim Rakipaj	2,727,738	2,717,154
Administratori Hasan Hafizi	479,235	-
Administratori Genc Hafizi	350,100	420,120
	3,557,073	3,137,274

29. Pasivet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënimë të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënimë për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

30. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

